REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53-13/2018 (JR)
Nr. 53-13/2018/2 regj.

Tiranë, më 03.03.2026

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton të gjithë personat e interesuar, se ditën e martë, më datë **24.03.2026, ora 09:20**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, çështja që i përket kërkesës së paraqitur nga **znj. Alma Brati**, për rishikimin e vendimit nr. 14 (JR), datë 09.07.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3, Tiranë.
Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese	**Ina Rama**
Relatore	**Natasha Mulaj**
Anëtare	**Rezarta Schuetz**
Anëtare	**Albana Shtylla**
Anëtare	**Mimoza Tasi**

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në kërkesë. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të kërkuesit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

INA RAMA